



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.363, datë 16.11.2021

**“MBI VERIFIKIMIN E PASURISË DHE FIGURËS TË KANDIDATES
PËR T’U PRANUAR NË PROGRAMIN E FORMIMIT FILLESTAR
TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2021-2022
ZNJ. INES DANI**

Bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 1, të nenit 159, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në germën “b”, pika 4/1, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, germa “a”, të pikës 8, të Seksionit Ç, të Kreut VI, të Rregullores “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, e ndryshuar, si dhe pasi u njoh me Relacionin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale “Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të znj. Ines Dani, kandidate për t’u pranuar në programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2021-2022”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Të konsiderojë të përfunduar procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës të kandidates znj. Ines Dani, për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022, sipas Relacionit bashkëlidhur.
2. Ndalimin e kandidates znj. Ines Dani për t’u pranuar në Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës, në vitin akademik 2021-2022.
3. Vendimi i arsyetuar me shkrim, i njoftohet znj. Ines Dani brenda 5 ditëve nga data e shpalljes dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi sipas ligjit në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve, nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**



**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**



**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**



**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**



**ANËTAR
MOISI DUDA**



**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BECI**



**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

